

VENDIM
Nr. 91, datë 17.2.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA MIRDITË, TË NJË PJESE TË PRONË NR. 988, ME EMËRTIM “ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5014”, ME VENDNDODHJE NË RRËSHEN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Mirditë, të një pjese të pronës nr. 988, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5014”, me vendndodhje në Rrëshen, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e banesave individuale dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit në Njësinë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, për të prekurit nga tërmeti i datës 26.11.2019.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet nga prona nr. 988, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5014”, me vendndodhje në Rrëshen, sipërfaqja sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Mirditë.

3. Bashkisë Mirditë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, Bashkia Mirditë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI
Prona Nr.988 "Ish Rep.Usht. Nr.5014", Rrëshen

PRONARI: SHTET/ Në përgjegjësi administrimi Ministria e Mbrojtjes DATË 16/02/2021 QËLLIMI: Transferim

VENDNDODHJA

Bashkia: Mirditë DVASHK/ZVASHK Mirditë Nr.Pasurisë 1/12 ZK 3224 Indeksi i Hartës Rr B-2


TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë: Truall Sip e pasurisë 36 160m² Sip e gjurmës së ndërtimit = 3 124m² Nr. kateve Nr. pemeve

X = 489 114.09
Y = 4 626 179.429

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

X = 489 554.00
Y = 4 626 179.429



X = 489 114.09
Y = 4 625 828.358

SH 1: 2500

X = 489 554.00
Y = 4 625 828.358

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Vari			1/12 ZK 3224	
2	Lundje			1/12 ZK 3224	
3	Jug			1/12 ZK 3224	
4	Perëndim			1/12 ZK 3224	

Realizoi IGJIU Topograf Ramiz Haxhiu

DREJTORI I IGJIU
 Ark. Edna SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti

DVASHK

Nënshkrimi

KONFIRMOI

Përgjegjësi/Drejtori

Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE

Kodet për teknologjinë e matjeve: Z-Zyrtë, sipas Planrilevimit orientuar hartuar nga ASHK, Tiranë B/lidhur shkresës

PËRCAKTIMI I KUFIRIT

Kodet për Përcaktimin e kufirit: P-Perfaqësuesi i Pronarëve; K-Kufitarët të gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;

PB-Perfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA:

Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Shetit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nr.868/1, datë 11.02.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik b/lidhur kësaj shkrese.

PRONARI/BASHKIPRONARËT-DEKLARIM NË LIDHJE ME KUFITARËT

EMRI

NËNSHKRIMI